



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

BULETINI

Mars, 2008 Nr. 18

MBLEDHJA E JASHTËZAKONSHME E KUVENDIT TË KOSOVËS

Kosova shpallet shtet i pavarur, i lirë, sovran dhe demokratik



- U aprovuan njëzëri Deklarata e Pavarësisë së Kosovës dhe simbolet shtetërore të Kosovës
- Kushtetuta jonë parasheh që Kosova është shtet i të gjithë qytetarëve të saj
- Nuk ka hapësirë për frikësim, diskriminim ose trajtim jo të barabartë për askënd
- Kuvendi zgjodhi udhëheqjen e re të Kosovës: kryetar i Kosovës - Fatmir Sejdiu, kryetar i Kuvendit - Jakup Krasniqi, kryeministër - Hashim Thaçi

U bisedua për vendosjen e Misionit EULEX në Kosovë



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Jakup Krasniqi, ka pritur sot kryesuesin e Misionit EULEX, në Kosovë, Yves De Kermabon dhe ka biseduar me të për rolin dhe përmasat e Misionit EULEX në Kosovë, shumë të rëndësishëm për forcimin demokracisë e të sigurisë dhe për funksionimin e shteti ligjor në Kosovë, pas shpalljes së pavarësisë së vendit dhe njohjes nga një varg shtetesh të fuqishme të botës. Duke i uruar mirëseardhje në detyrën e tij të re në Kosovës dhe suksese në krye të Misionit EULEX, kryeparlamentari Krasniqi shprehu kënaqësinë që në krye të një misioni kaq të rëndësishëm të Unionit Evropian në Kosovë, vjen njeriu i dëshmuar, i cili e njeh mirë situatën politike dhe të sigurisë në Kosovës. Krasniqi ka uruar që Misioni EULEX të vendoset dhe të veprojë në gjithë territorin e Kosovës dhe t'i arrijë objektivat e parapara. Ai i ka premtuar z. De Kermabon angazhimin e Kuvendit të Kosovës për të miratuar gjithë rregullativën e

nevojshme për të vepruar EULEX-i në mënyrë të suksesshme në Kosovë. Kryesuesi i Misionit EULEX, në Kosovë, Yves De Kermabon, ka shprehur kënaqësinë që prapë ndodhet në një detyrë të rëndësishme në Kosovë, për të ndihmuar funksionimin e shtetit demokratik dhe shumetnik të Kosovës. Ai, me këtë rast, ka shpjeguar se do të angazhohet fuqishëm për të luftuar krimin e organizuar, për të ngritur sigurinë e Kosovë dhe për të krijuar rrethana të volitshme për funksionimin e shtetit ligjor. De Kermabon është shprehur i bindur se EULEX do të funksionojë në tërë territorin e Kosovës, duke përçarur mesazhe tek të gjithë qytetarët e Kosovës se Misioni i Unionit Evropian është për të mirë të tyre. Ai ka pohuar se EULEX-i do të monitorojë institucionet e Kosovës, por edhe do të bashkëpunojë ngushtësisht me to për të siguruar paqe, stabilitet dhe përparim gjithëpërfshirës të shoqërisë së Kosovës.



Përmbajtja:

Kosova shpallet shtet i pavarur, i lirë, sovran dhe demokratik.....3

Institucionet e Kosovës kanë arritur një nivel të lartë të pjekurisë..... 10

Kosova do të funksionojë në tërësinë e saj territoriale.....17

Përkushtimin i veçantë i parlamentarëve për të ecur përpara në ndërtimin e shtetit ligjor.....19

Gjatë këtij viti Kosovën pritet ta njohin mbi njëqind shtete21

Redaksia:

Sherif Konjufca, Shefqet Rexhepi,
Celal Ilyas, Edona Fetahu

Telefonat kontaktues:

038 / 211 186 / 211 949;
038 / 211 189; 044 / 127 921

Tel/Fax: 038 211 188

E-mail: media@assembly-kosova.org

Web faqja: www.assembly-kosova.org

Kosova shpallet shtet i pavarur, i lirë, sovran dhe demokratik

U aprovuan njëzëri Deklarata e Pavarësisë së Kosovës dhe simbolet shtetërore të Kosovës. - Kushtetuta jonë parasheh që Kosova është shtet i të gjithë qytetarëve të saj. - Nuk ka hapësirë për frikësim, diskriminim ose trajtim jo të barabartë për askënd



Sot, u mbajt mbledhja e jashtëzakonshme solemne dhe plenare e Kuvendit të Kosovës , e kryesuar nga Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, në rendin e ditës të së cilës ishin miratimi i Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës dhe miratimi i simboleve shtetërore të Kosovës. Kërkesa e përbashkët për këtë mbledhje u shtrua nga kryetari i Kosovës, Fatmir Sejdiu dhe kryeministri i Kosovës , Hashim Thaçi. Në mbledhje , në

të cilën merrnin pjesë 109 deputetë, ishin të pranishëm edhe shumë mysafirë, nga radhët e përfaqësive diplomatike, si dhe pjesëtarët e familjes së Adem Jasharit dhe të ish- presidentit Ibrahim Rugova.

Kosova po e hap sot një faqe të re të historisë

Duke përshëndetur të pranishmit kryeparlamentari Jakup Krasniqi tha se Kosova po e hap sot një

faqe të re të historisë dhe po e ndërron hartën politike të Evropës. Duke lënë pas kujtimet e hidhura të urrejtjes e të konflikteve tragjike, ne po hyjmë në epokën e pavarësisë, të paqes dhe të përparimit të vendit tonë. Paqe dhe liri të vërtetë mund të ketë vetëm midis të barabartëve. Kosova e pavarur do të jetë atdheu i qytetarëve të barabartë e të lumtur, duke u ngritur mbi themelet e vlerave më të mira të

tradiçës së saj dhe sipas parimeve të demokracisë moderne. Brezi i sotëm i Kosovës ka privilegj të veçantë për kthesën e madhe historike, që i bën nder, por bashkë me të ka edhe përgjegjësinë e lartë të ndërtimit demokratik e evropian të atdheut të vet dhe të brezave që

do ta trashëgojnë. Zotimi ynë solemn për Kosovën shtet demokratik, është kontrata me qytetarët e saj dhe partneriteti me bashkësinë ndërkombëtare, është premtimi i përkushtimit jetësor për vlerat më të përparuara e themeltare të shoqërisë së sotme

njerëzore.

Kosova, asnjëherë në jetën e saj nuk ka pasur miq sa ka sot, por nesër do të ketë edhe më shumë. Kultura dhe rendi demokratik, shteti ligjor, përkushtimi paqekrijues, fqinjësia e mirë dhe fryma e dialogut, respektit dhe besimit, do

Deklarata e Pavarësisë së Kosovës

Të mbledhur në mbledhje të jashtëzakonshme më 17 shkurt 2008, në kryeqytetin e Kosovës, në Prishtinë,
Duke iu përgjigjur thirrjes së popullit për të ndërtuar një shoqëri që respekton dinjitetin njerëzor dhe afirmon krenarinë dhe synimet e qytetarëve të saj,
Të zotuar për t'u përballur më trashëgiminë e dhembshme të së kaluarës së afërt në frymë të pajtimit dhe faljes,
Të përkushtuar ndaj mbrojtjes, promovimit dhe respektimit të diversitetit të popullit tonë,
Duke riafirmuar dëshirën tonë për t'u integruar plotësisht në familjen euroatlantike të demokracive,
Duke vërejtur se Kosova është një rast special që del nga shpërbërja jokonsensuale e Jugosllavisë dhe nuk është presedan për cilëndo situatë tjetër,
Duke rikujtuar vitet e konfliktit dhe dhunës në Kosovë që shqetësuan ndërgjegjen e të gjithë popujve të civilizuar,
Mirënjohës që bota intervenoi më 1999 duke hequr në këtë mënyrë qeverisjen e Beogradit mbi Kosovën, dhe vendosur Kosovën nën administrimin e përkohshëm të Kombeve të Bashkuara,
Krenarë që Kosova që atëherë ka zhvilluar institucione funksionale, multietnike të demokracisë që shprehin lirisht vullnetin e qytetarëve tanë,
Duke rikujtuar vitet e negociatave të sponsorizuara ndërkombëtarisht ndërmjet Beogradit dhe

Prishtinës mbi çështjen e statusit tonë të ardhshëm politik,
Duke shprehur keqardhje që nuk u arrit asnjë rezultat i pranueshëm për të dyja palët përkundër angazhimit të mirëfilltë të udhëheqësve tanë,
Duke konfirmuar se rekomandimet e të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara, Martti Ahtisaari, i ofrojnë Kosovës një kornizë gjithëpërfshirëse për zhvillimin e saj të ardhshëm, dhe janë në vijë me standardet më të larta evropiane për të drejtat të njeriut dhe qeverisjen e mirë,
Të vendosur që ta shohim statusin tonë të zgjidhur në mënyrë që t'i jepet popullit tonë qartësi mbi të ardhmen e vet, të shkohet përtej konflikteve të së kaluarës dhe të realizohet potenciali i plotë demokratik i shoqërisë sonë,

Duke nderuar të gjithë burrat dhe gratë që bënë sakrifica të mëdha për të ndërtuar një të ardhme më të mirë për Kosovën, miratoi **Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës**

1. Ne, udhëheqësit e popullit tonë, të zgjedhur në mënyrë demokratike, nëpërmjet kësaj Deklarate shpallim Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Kjo shpallje pasqyron vullnetin e popullit tonë dhe është në pajtueshmëri të plotë me rekomandimet e të Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara, Martti Ahtisaari, dhe Propozimin e tij Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës.

2. Ne shpallim Kosovën një republikë demokratike, laike dhe

multietnike, të udhëhequr nga parimet e jodiskriminimit dhe mbrojtjes së barabartë sipas ligjit. Ne do të mbrojmë dhe promovojmë të drejtat e të gjitha komuniteteve në Kosovë dhe krijojmë kushtet e nevojshme për pjesëmarrjen e tyre efektive në proceset politike dhe vendimmarrëse.

3. Ne pranojmë plotësisht obligimet për Kosovën të përmbajtura në Planin e Ahtisarit, dhe mirëpresim kornizën që ai propozon për të udhëhequr Kosovën në vitet në vijim. Ne do të zbatojmë plotësisht ato obligime, përfshirë miratimin prioritar të legjislationit të përfshirë në Aneksin XII të tij, veçanërisht atë që mbron dhe promovon të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.

4. Ne do të miratojmë sa më shpejt që të jetë e mundurshme një kushtetutë që mishëron zotimin tonë për të respektuar të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të gjithë qytetarëve tanë, posaçërisht ashtu siç definohej me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kushtetuta do të inkorporojë të gjitha parimet relevante të Planit të Ahtisaarit dhe do të miratohet nëpërmjet një procesi demokratik dhe të kujdesshëm.

5. Ne mirëpresim mbështetjen e vazhdueshme të bashkësisë ndërkombëtare për zhvillimin tonë demokratik nëpërmjet të pranive ndërkombëtare të themeluara në Kosovë në bazë të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999). Ne ftojmë dhe mirëpresim një prani ndërkombëtare civile për të mbikëqyrur zbatimin e Planit të

të jenë baza e zgjerimit të miqësisë dhe bashkëpunimit e partneritetit. Shfrytëzoj këtë rast solemn, të shpreh ndjenjën e përuljes së popullit të Kosovës ndaj gjithë atyre që u flijuan në altarin e lirisë së Kosovës. Me respekt të veçantë përshëndes

gjithë miqtë tanë, që me përkushtim ndihmuan Kosovën në çastet vendimtare dhe historike. Populli shqiptar dhe qytetarët e Kosovës do t'u jenë mirënjohës përjetë. Në këtë ditë të shënuar, ndihem i nderuar të përshëndes përfaqësuesin e familjes së madhe Jashari,

zotin Rifat Jashari. Familja Jashari është përfaqësuese e gjithë flujimeve për liri të popullit shqiptar, është institucioni më shumë se moral që ka dhe do ta ketë Kosova. Kam kënaqësinë t'ju përshëndes në emër të Kuvendit të Kosovës dhe në emrin tim, juve

Ahtisaarit dhe një mision të sundimit të ligjit të udhëhequr nga Bashkimi Evropian. Ne, po ashtu, ftojmë dhe mirëpresim NATO-n që të mbajë rolin udhëheqës në praninë ndërkombëtare ushtarake dhe të zbatojë përgjegjësitë që i janë dhënë sipas Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999) dhe Planit të Ahtisaarit, deri në atë kohë kur institucionet e Kosovës do të jenë në gjendje të marrin këto përgjegjësi. Ne do të bashkëpunojmë plotësisht me këto prani në Kosovë për të siguruar paqen, prosperitetin dhe stabilitetin në të ardhmen në Kosovë.

6. Për arsye të kulturës, gjeografisë dhe historisë, ne besojmë se e ardhmja jonë është në familjen evropiane. Për këtë arsye, ne shpallim synimin tonë për të marrë të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar anëtarësim të plotë në Bashkimin Evropian sapo që të jetë e mundur dhe për të zbatuar reformat e kërkuara për integrim evropian dhe euroatlantik.

7. Ne i shprehim mirënjohje Organizatës së Kombeve të Bashkuara për punën që ka bërë për të na ndihmuar në rimëkëmbjen dhe rindërtimin pas lufte dhe ndërtimin e institucioneve të demokracisë. Ne jemi të përkushtuar të punojmë në mënyrë konstruktive me Organizatën e Kombeve të Bashkuara gjersa ajo vazhdon punën e saj në periudhën në vijim.

8. Me pavarësinë vjen detyra e anëtarësisë së përgjegjshme në bashkësinë ndërkombëtare. Ne e pranojmë plotësisht këtë detyrë

dhe do t'i përmbahemi parimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara, Aktin Final të Helsinkit, akteve tjera të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, obligimeve ligjore ndërkombëtare dhe parimeve të marrëdhënies të mira ndërkombëtare që shënojnë marrëdhëniet ndërmjet shteteve. Kosova do të ketë kufijtë e saj ndërkombëtarë ashtu siç janë paraparë në Aneksin VIII të Planit të Ahtisarit, dhe do të respektojë plotësisht sovranitetin dhe integritetin territorial të të gjithë fqinjëve tanë. Kosova, po ashtu, do të përmbahet nga kërcënimi apo përdorimi i forcës në cilëndo mënyrë që është jokonsistente me qëllimet e Kombeve të Bashkuara.

9. Ne, nëpërmjet kësaj Deklarate, marrim obligimet ndërkombëtare të Kosovës, përfshirë ato të arritura në emrin tonë nga Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), si dhe obligimet e traktateve dhe obligimet tjera të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ndaj të cilave obligohemi si ish-pjesë konstitutive, përfshirë konventat e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike dhe konsullore. Ne do të bashkëpunojmë plotësisht me Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë. Ne synojmë të kërkojmë anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, në të cilat Kosova do të synojë të kontribuojë për qëllime të paqes dhe stabilitetit ndërkombëtar.

10. Kosova shpall zotimin e saj ndaj paqes dhe stabilitetit në rajonin tonë të Evropës Juglindore.

Pavarësia jonë e sjell në fund procesin e shpërbërjes së dhunshme të Jugosllavisë. Gjersa ky proces ka qenë i dhembshëm, ne do të punojmë pa pushim për t'i kontribuar një pajtimi që do të lejonte Evropën Juglindore të shkojë përtej konflikteve të së kaluarës dhe të farkojë lidhje të reja racionale të bashkëpunimit. Për këtë arsye, do të punojmë së bashku me fqinjët tanë për të avancuar të ardhmen tonë të përbashkët evropiane.

11. Ne shprehim, në veçanti, dëshirën tonë për të vendosur marrëdhënie të mira me të gjithë fqinjët tanë, përfshirë Republikën e Serbisë, me të cilën kemi marrëdhënie historike, tregtare dhe shoqërore, të cilat synojmë t'i zhvillojmë më tej në të ardhmen e afërt. Ne do të vazhdojmë përpjekjet tona për t'i kontribuar marrëdhënies të fqinjësisë dhe bashkëpunimit me Republikën e Serbisë duke promovuar pajtimin ndërmjet popujve tanë.

12. Ne, nëpërmjet kësaj, afirmojmë në mënyrë të qartë, specifike dhe të përvokueshme se Kosova do të jetë ligjërish e obliguar të plotësojë dispozitat e përmbytura në këtë Deklaratë, përfshirë këtu veçanërisht obligimet e saj nga Plani i Ahtisaarit. Në të gjitha këto çështje, ne do të veprojmë në pajtueshmëri në parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe rezolutat e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, përfshirë Rezolutën 1244 (1999). Ne shpallim publikisht se të gjitha shtetet kanë të drejtën të mbështeten në këtë Deklaratë, dhe i bëjmë apel të na ofrojnë përkrahjen dhe mbështetjen e tyre.

dhe të gjithë ata që po na përcjellin kudo në botë në këto çaste, duke ju dëshiruar mirëseardhje në këtë seancë solemne.

Po bëhemi pjesë e barabartë e botës demokratike

Në vijim kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, paraqiti para deputetëve arsyetimin për konvokimin e kësaj mbledhjeje të jashtëzakonshme, duke theksuar se bashkë me presidentin, Fatmir Sejdiu, ka vendosur të thërrasë këtë mbledhje në përputhshmëri me

jashtë vendit të cilët na kanë ndihmuar të mbërrijmë deri këtu. I përshëndes të gjithë ata që janë sot këtu me ne ndërsa atyre që janë duke na shikuar në këto momente, u shpreh mirënjohjen më të thellë në emër të popullit tim. Kjo ditë erdhi, e nga sot e tutje Kosova është krenare, e pavarur, sovrane dhe e lirë.

Familja ime, sikurse tuajat dhe të gjitha familjet në tërë Kosovën nuk u luhatën kurrë dhe nuk e humbën asnjëherë besimin në ne. Besimin në zot, drejtësi dhe fuqi. Duke filluar më vëllanë që la

mesin e shteteve të lira të botës. Të gjithë ne së bashku e sollëm Kosovën në këtë moment -dhe të gjithë duhet të jemi shumë, shumë krenarë. Ashtu sikur prindërit dhe gjyshërit e mi që më mësuan mua për sakrificë, se çka do të thotë të jesh i lirë, nga ju kërkoj që të flisni me fëmijët, nipat dhe mbesat tuaja që t'ua shpjegoni domethënien e ditës së sotme. Barteni këtë rrëfim tek brezat tjerë për gëzimin dhe krenarinë që ndiejmë ne sot dhe mos harroni asnjëherë t'ua përkujtioni atyre që t'i kujtojnë sakrifi-



DETAJ NGA NËNSHKRIMI I DEKLARATËS

Kornizën Kushtetuese. Këtë ditë e kemi pritur gjatë.

Shumë njerëz kanë dhënë kaq shumë për ta bërë realitet këtë ditë të pavarësisë. Sot, ne nderojmë ata që na kanë nderuar neve me sakrificën e tyre. Ne i mbajmë mend emrat e tyre ndërsa kujtimin për ta do ta ruajmë përgjithmonë në zemrat tona. Ne jemi mirënjohës miqve dhe aleatëve tanë në vend dhe

familjen e tij dhe shkoj për të luftuar, nga bujku që la tokën e tij pa mbjellë, nga burrat dhe gratë që hapën portat e tyre dhe mësuan fëmijët tanë, e deri tek studentët të cilët u ngritën dhe thanë 'mjajt'. Të gjithë atyre që janë kthyer për të ndërtuar një jetë më të mirë për fëmijët e tyre: ne nuk humbëm kurrë besimin në ëndrrën se një ditë ne do të qëndrojmë në

cat e mëdha të brezave që ishin para nesh.

Kosova, në vitet e ardhshme, do të përballlet me shumë sfida.

Por, asnjë sfidë nuk do të na zmbrebs nga ecja jonë përpara në një frymë të bashkuar të një populli të bashkuar. Sfidat tona, që nga ekonomia, arsimit dhe shëndetësia, infrastruktura dhe integrimi evropian, janë sfida të mëdha, por

nuk mund t'u bëjnë ballë frymës pozitive të qytetarëve tanë dhe fatit tonë.

Kosova, populli dhe territori, janë bashkuar sot në një moment historik për t'i përmirësuar jetën e çdo qytetari brenda kufijve tanë, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike. Shpresat tona nuk kanë qenë asnjëherë më të mëdha. Ëndrrat tona janë të pakufishme.

Garantimi i fuqishëm dhe i pakthyesëm me ligj i të drejtave të barabarta të të gjithë pjesëtarëve të komuniteteve

Sfidat para nesh janë të mëdha por asgjë nuk mund të na ndalë nga ecja jonë përpara drejt çasteve historike të cilat historia i ka ndarë për ne. Sot, e gjithë bota është me ne-ne po bëhemi pjesë e barabartë e botës demokratike. Deri tash kemi bërë shumë për të garantuar zotimin tonë para komuniteteve. Në këtë ditë historike dëshiroj ta konfirmoj gatishmërinë tonë politike për të krijuar kushtet e nevojshme për respektimin dhe mbrojtjen e komuniteteve dhe për të përmirësuar raportet midis tyre në Kosovë. Kushtetuta dhe ligjet tona do ta pasqyrojnë këtë së bashku me një strategji ndërinstitutionale në të gjitha nivelet e shtetit. Këto zotime tonat do të mishërohen në tri elemente kryesore:

E para, garantimi i fuqishëm dhe i pakthyesëm me ligj i të drejtave të barabarta të të gjithë pjesëtarëve të komuniteteve në Kosovë;

E dyta, krijimi i mekanizmave të përhershëm për të garantuar që komunitetet të luajnë një rol të plotë dhe aktiv në zhvillimin e së ardhmes së vendit tonë;

dhe e treta, është përgjegjësia jonë për të marrë masa efektive dhe të menjëhershme për të siguruar që

zotimet tona të rezultojnë në ndryshime pozitive për të gjithë ata që jetojnë në Kosovë, e në veçanti për pjesëtarët e komuniteteve.

Kushtetuta jonë parasheh që Kosova është shtet i të gjithë qytetarëve të saj. Nuk ka hapësirë për frikësim, diskriminim ose trajtim jo të barabartë për askënd. Çdo praktikë diskriminuese do të çrënjaset nga institucionet tona shtetërore. Në vend të kësaj, të gjithë pajtohen se shumëllojshmëria sjell përfitime pozitive për të gjithë.

Danashnji dan označva kraj jednog dugog procesa. Ovo je kraj zadnjih pretnji i zabluda da će Kosovom ikada više vladati Beograd. Sami Kosovari, svih etničkih, verskih i jezičkih pripadnosti će jedno nositi odgovornosti o svojoj zemlji. Mi činimo Kosovo nezavisnim sa ciljem da slobodu i ostale blagodati naše zemlje uživaju svi građani. Neka ovo bude dan novog početka. Neka ovaj dan označi početak bolje budćnosti za sve naše građane države Kosovo. Neka naš Dan Nezavisnosti bude slavljem u narednim godinama i vekovima u potpunom miru, pravdi i blagostanju.

Kosova po e shpall pavarësinë e saj në përputhje me Propozimin Gjithëpërfshirës të Ahtisarit. Pavarësia e Kosovës shënon fundin e shpërbërjes së ish- Jugosllavisë. Zbatimi i dispozitave të Ahtisarit të cilat janë inkuorporuar në Kushtetutën e Kosovës janë prioritet nacional për ne. Kuvendi i Kosovës do të miratojë të gjitha ligjet kryesore që dalin nga dokumenti i Ahtisarit në ditët në vijim.

Kosova çmon rolin të cilin e ka luajtur OKB-ja në rindërtimin e Kosovës dhe të ndërtimit të insti-

tucioneve tona.

Raporte të mira me të gjitha vendet fqinje

Presim të punojmë me OKB-në për të avancuar përpjekjet tona të përbashkëta për paqen, sigurinë dhe zhvillimin demokratik. Gjithashtu, ne mirëpresim misionin e ri ndërkombëtar të udhëhequr nga Bashkimi Evropian i cili do të na ndihmojë në zhvillimin tonë demokratik dhe do ta mbikëqyr zbatimin e planit të Ahtisarit. Me këtë rast, dua t'i siguroj fqinjët tanë se Kosova do të bëjë çmos që të vendos dhe mbajë raporte të mira me të gjitha vendet fqinje. Ne aspirojmë të kemi raporte të mira të ndërsjella në interesin e përbashkët edhe me Beogradin me besimin se kjo është në interesin tonë të përbashkët.

Që nga sot, Kosova do të jetë shtet demokratik dhe shumë-etnik i të gjithë qytetarëve të saj, në rrugëtimin e saj të shpejtë drejt integriteteve euroatlantike.

Kujtojmë shumë sakrifica që i kanë paraprirë kësaj dite të jashtëzakonshme

Duke marrë fjalën presidenti Fatmir Sejdiu tha se dita e sotme e ndan historinë e Kosovës në dysh: në epokat para dhe pas pavarësisë. Pavarësinë e Kosovës e kanë krijuar breza të tërë me veprën e tyre jetësore, me punë të palodhshme dhe me sakrificat që kanë bërë. Pavarësinë tonë po e shpallim para dhe me bekimin e botës, në mes miqsh tanë që u gjetën pranë nesh gjatë dekadave e sidomos para një dekade kur e keqja kishte përfshirë këtë pjesë të Ballkanit. Po të njëjtit miq ishin me ne edhe gjatë rimëkëmbjes së pasluftës, rindërtimit të vendit të shkatërruar nga lufta dhe okupimi.

Sot, kujtojmë shumë sakrifica që i kanë paraprirë kësaj dite të jashtëzakonshme. I kujtojmë nënat dhe baballarët të cilët përjetuan vështirësi të papërshkrueshme në mënyrë që bijtë dhe bijat e tyre të mund të jetonin të lirë. Sot, kujtojmë Presidentin Ibrahim Rugova, udhëheqësin e madh dhe themelтарin e shtetit tone, i cili e nxori Kosovën nga kaosi në rend demokratik. Sot, kujtojmë Adem Jasharin dhe Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës që e çuan tutje vullnetin e popullit të Kosovës për të qenë të lirë. Po ashtu kujtojmë edhe fqinjët tanë të të gjitha përkatësive etnike, ideologjike e religjioze të cilët na dolën në ndihmë gjatë viteve të represionit dhe luftës. I kujtojmë të gjitha këto jo në shenjë hakmarrjeje për të kaluarën e dhunshme, por për të ndërtuar një të ardhme plot besim që do të ofrojë ambient për pajtim dhe falje.

Këto ngjarje të madhërisme të historisë sonë – sakrificat tona, si dhe shpresat dhe arritjet tona – na kanë sjellë sot këtu për të shpallur pavarësinë tonë. Kjo shpallje e pavarësisë është vullnet i popullit. Është rrjedhojë morale dhe logjike e historisë sonë dhe është në pajtueshmëri të plotë me rekomandimet e të Dërguarit Special Marti Ahtisari. Pavarësia e Kosovës shënon fundin e procesit të gjatë të shpërbërjes së Jugosllavisë. Pas dy vitesh angazhimi në negociata të mirëfillta mbi statusin me Beogradin dhe përkundër angazhimit serioz dhe konstruktiv të Ekipit të Unitetit të Kosovës, arritja e një zgjidhjeje të pranueshme për dy palët nuk ishte e mundshme. Prandaj, u desh të vepronim për t'i ofruar popullit tonë një perspektivë të qartë me qëllim të avancimit të zhvillimit tonë poli-

tik, shoqëror dhe ekonomik. Vizioni ynë për Kosovën është shumë i qartë. Dëshirojmë që Kosovën ta ndërtojmë mbi parimet fundamentale demokratike. Kjo do të thotë se Kosova do të jetë një shtet demokratik, shumetnik, i integruar në rajon, me marrëdhënie të mira fqinjësore me shtetet përreth, një shtet që lëviz shpejt drejt anëtarësimi të plotë në Bashkësinë Euro-atlantike. Populli i Kosovës është përcaktuar dhe dëshiron një të ardhme evropiane për vendin e vet.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës u garanton komuniteteve pakicë pjesëmarrje të gjithanshme dhe kuptimplote në vendimmarrje

Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës në mars të vitit të kaluar ka marrë edhe përkrahjen e Kuvendit të Kosovës. Kjo pako u jep serbëve, por edhe pakicave tjera: turqve, boshnjakëve, romëve, ashkalinjëve dhe egjiptasve, garanci të fuqishme për mbrojtjen e të drejtave të tyre kulturore e politike, që në shumë pika tejkalojnë edhe standardet më të avancuara ndërkombëtare për të drejtat e pakicave. Kushtetuta e Republikës së Kosovës u garanton komuniteteve pakicë pjesëmarrje të gjithanshme dhe kuptimplote në vendimmarrje.

Prioritet nacional për Republikën e Kosovës në javët dhe muajt e ardhshëm është zbatimi i plotë i Planit të Ahtisarit. Shumë shpejt synojmë të miratojmë ligjet dhe Kushtetutën e re të Kosovës e cila mishëron edhe parimet e Ahtisarit. E gjithë kjo do të pasohet me veprime konkrete në terren për zbatimin e dispozitave që përm-

ban plani i Presidentit Ahtisari. Kosova me aktin e sotëm po ashtu po merr përgjegjësitë që i takojnë si shtet. Në të njëjtën kohë, Kosova rithekson përkushtimin për bashkëpunim të ngushtë me Bashkësinë Ndërkombëtare për ndërtimin e një shteti në pajtim me normat dhe parimet më të avancuara të demokracisë. Për këtë qëllim Kosova mirëpret vendosjen e pranisë civile ndërkombëtare, e cila do të mbështesë zhvillimin e mëtejshëm demokratik të vendit tonë por, edhe do të mbikëqyrë zbatimin e Planit të Ahtisarit. Në veçanti, vlerësojmë gatishmërinë e BE-së për të marrë një rol më të madh në Kosovë. Po ashtu mirëpresim vazhdimin e pranisë ushtarake të trupave të NATO-s. Zotohemi se do të bashkëpunojmë ngushtë me përfaqësuesit civilë dhe ushtarakë në Kosovë.

Jemi të vetëdijshëm se pjesëtarë të komuniteteve pakicë në Kosovë e shikojnë pavarësinë me frikë dhe skepsë. Ne do të bëjmë çmos që të sigurohemi se të drejtat, kultura dhe prona e tyre do të respektohen në mënyrë rigorozë në Kosovën e pavarur.

Još jednom želim da iskoristim ovu svečanu priliku da ponovo pozivam sve građane Kosova, pre svega građane srpske zajednice na Kosovu da daju svoj doprinos u zajedničkoj izgradnji jednog Evropskog Kosova u kojem svaki građanin će se osećati u svojoj kući. Kosovo je podjednako vaša kuća i vaša domovina. Vaša prava i prava pripadnika drugih zajednica u nezavisnom Kosovu biće stalna obaveza naših državnih institucija. Srpsko kulturno i religiozno nasleđe biće potpuno zaštićeno. Vas etnički i jezični identitet biće potpuno poštovan. A to ćemo ostvariti zajedničkim radom u svakodnevnom životu i u

institucijama Kosova. Duam të theksojmë fuqishëm se Kosova dëshiron marrëdhënie të fqinjësisë së mirë edhe me Serbinë mbi bazën e respektimit të ndërsjellë. Shpresojmë se synimi ynë për të normalizuar marrëdhëniet me Beogradin sa më shpejt që të jetë e mundur do të përkrahjet edhe nga Serbia.

Jemi mirënjohës për rolin dhe punën që ka bërë OKB-ja në rindërtimin e Kosovës së pasluftës. OKB-ja do të vazhdojë të luajë një rol në Kosovë për aq kohë sa Rezoluta 1244 do të jetë në fuqi. Do të vazhdojmë të bashkëpunojmë me OKB-në për të avancuar qëllimet tona të përbashkëta për paqe, siguri dhe zhvillim demokratik të Kosovës deri në anëtarësimin e plotë të Kosovës në këtë organizatë prestigjioze.

Republika e Kosovës sot kërkon përqafimin e botës

Integrimi ynë do të rrjedhë natyrshëm sepse me vlerat e veta Kosova kulturalisht i ka takuar kësaj familjeje gjithnjë, por tashti në rrethanat e reja Kosovës i duhet integrimi politik për të krijuar mundësi të reja në mënyrë që resurset njerëzore dhe natyrore të vihen në shërbim të zhvillimit të gjithanshëm shoqëror e ekonomik të vendit tonë.

Republika e Kosovës sot kërkon përqafimin e botës. Ndërsa presim njohje të sh-

pejtë nga shumë vende të botës, me pietet të veçantë kujtojmë shumë personalitete të mëdha botërore që qëndruan përkrah popullit të Kosovës gjatë dekadave e sidomos gjatë orëve më të vështira të tij.

Populli ynë do të dijë t'u jetë përjetësisht mirënjohës Shteteve të Bashkuara të Amerikës, vendeve të Bashkimit Evropian, NATO-s dhe vendeve të tjera të botës demokratike për përkrahjen e pazëvendësueshme për vendin tone, Kosovën.

Deputetët votuan njëzëri Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës

Para deputetëve, pastaj, kryeministri i Kosovës Hashim Thaçi prezantoi Deklaratën e Pavarësisë, i shoqëruar me duartrokitje frenetike. Thaçi me këtë rast shprehu edhe mirënjohjen e madhe për përkrahjen e Kosovës nga ana e SHBA-së dhe Bashkimit Evropian. Deputetët pastaj votuan njëzëri Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

Pas votimit të shoqëruar me duartrokitje të gjata, Jakup Krasniqi tha se me këtë akt Kosova shpallet shtet i pavarur, i lirë dhe sovran. Kryetari i Kosovës Sejdiu, kryeministri Thaçi, kryeparlamentari Krasniqi, si dhe të gjithë deputetët, pastaj nënshkruan solemnisht Deklaratën e Pavarësisë. Deputetët e Kuvendit të Kosovës votuan njëzëri edhe simbolet shtetërore të Kosovës, flamurin dhe stemën.

U nënshkrua projekti mbështetjes së Kuvendit të Kosovës nga UNDP-ja

Në prani të zonjës Kori Udovicki, asistente e Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së dhe drejtoreshë regjionale e UNDP-së (Evropë dhe vendet e ish-BRSS-së) dhe zonjës Kathleen Cravero, drejtoreshë e Byrosë së UNDP-së për parandalimin e krizave dhe rimëkëmbje, sot në Kuvendin e Kosovës është nënshkruar Projekti për mbështetjen në përmbushjen e objektivave të Deklaratës së OKB-së për mijëvjeçarin dhe agjendën evropiane për përfshirjen sociale.

Projekti i nënshkruar nga kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi dhe Frode Muring, koordinator i agjencive të OKB-së në Kosovë dhe përfaqësues i përhershëm i UNDP-së në Kosovë, ka për synim mbështetjen e Kuvendit për përmbushjen e objektivave të mijëvjeçarit, si: zhdukja e varfërisë së skajshme dhe urisë, arritja e arsimimit të përgjithshëm fillor, promovimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i femrave, zvogëlimi i vdekshmërisë të fëmijët, përmirësimi i shëndetit të nënave, luftimi i HIV/AIDS-it, tuberkulozit dhe sëmundjeve të tjera ngjitëse, sigurimi i qëndrueshmërisë së ambientit dhe krijimi i një partneriteti global për zhvillim. Para nënshkrimit të këtij projekti, kryeparlamentari Krasniqi i ka pritur përfaqësuesit e UNDP-së, zonjat Kori Udovicki e Kathleen Cravero, z.Frode Muring dhe bashkëpunëtorët e tyre, me të cilët ka biseduar për thellimin e bashkëpunimit të ndërsjellë dhe për mbështetjen që UNDP-ja do t'i japë Kosovës, në mënyrë dhe vendi t'i arrijë objektivat e mijëvjeçarit (deri më 2015).

“Kuvendi i Kosovës, në afatin më të shkurtër, me një rezolutë, do ta aprovojë Deklaratën së OKB-së të mijëvjeçarit, të cilën në vitin 2000 e kanë nënshkruar 189 vende”, ka premtuar Krasniqi.

Përfaqësuesit e UNDP-së janë zotuar se organizata, të cilën e përfaqësojnë, do të mbetet në Kosovë dhe do ta ndihmojë zhvillimin e vendit, duke e ngritur nivelin e pranisë në Zyrë, sikurse edhe në vendet e tjera të rajonit.

Institucionet e Kosovës kanë arritur një nivel të lartë të pjekurisë

Kuvendi zgjodhi udhëheqjen e re të Kosovës: kryetar i Kosovës- Fatmir Sejdiu, kryetar i Kuvendit, Jakup Krasniqi, kryeministër Hashim Thaçi. - Institucionet e Kosovës janë të përkushtuara që të mbrojnë dhe garantojnë liritë dhe të drejtat e të gjitha grupeve etnike joshumicë

Më 4 janar të këtij viti, në sallën e seancave plenare të Kuvendit të Kosovës, në prani të kryetarit të Kosovës, Fatmir Sejdiu, PSSP-së, Joakim Ryker, mandatarit të Qeverisë, Hashim Thaçi, të të dërguarit të posaçëm të Unionit Evropian, Fletcher Burton, zv.shëfit të Zyrës amerikane në Prishtinë, Alex Laskaris dhe përfaqësuesve të shumtë vendorë dhe ndërkombëtarë, u konstituua përbërja e re e Kuvendit të Kosovës.

Në seancën e drejtuar nga deputeti më i vjetër i Kuvendit, Mark Krasniqi, i ndihmuar nga deputetja më e re, Njomza Emini, fillimisht është formuar Komisioni për Mandate dhe Imunitete, i cili ka verifikuar mandatet e deputetëve, sipas rezultatit të zgjedhjeve parlamentare të 17 nëntorit. Të 112 kuvendarët e pranishëm në seancë dhanë betimin solemn të deputetit.

Seancës konstituive të Legjislaturës së Tretë iu drejtua edhe kryeadministratori Ryker, i cili i ka uruar punë të mbarë përbërjes së re të Kuvendit. “Deputetët e rinj do t’i ndjekin hapat e Kuvendit shumë të suksesshëm, i cili ka përcjellë disa zhvillime shumë të rëndësishme në institucionet e Kosovës, si dhe lidhur me procesin e statusit. Po ashtu dëshiroj t’i shpreh mirënjohje Kuvendit të

mëparshëm duke përfshirë kryetarin dhe anëtarët e Kryesisë”, ka thënë Ryker, i cili ka vlerësuar se institucionet e Kosovës kanë arritur një nivel të lartë të pjekurisë.

Në vazhdimin e sotëm të seancës konstituive të Kuvendit të Kosovës të 9 janarit të vitit 2008, të drejtuar nga deputeti më i vjetër, në moshë, Mark Krasniqi, i ndihmuar nga deputetja më e re, Njomza Emini, deputetët e përbërjes së re të Kuvendit të Kosovës kanë zgjedhur z. Jakup Krasniqi kryetar të Kuvendit, si dhe pesë anëtarë të tjerë të Kryesisë së Kuvendit, zotërinjtë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi dhe Nexhat Daci. Dy anëtarë të Kryesisë nga subjektet politike që përfaqësojnë qytetarët serbë të Kosovës dhe të atyre që përfaqësojnë subjektet politike joshqiptare dhe joserbe, ka mbetur të zgjidhen në ndonjë seancë tjetër, pasi që të pajtohen subjektet e tyre politike.

Kryetari i sapozgjedhur i Kuvendit, Jakup Krasniqi, ka marrë pastaj drejtimin e seancës, i ndihmuar nga anëtari i Kryesisë, Eqrem Kryeziu, kurse deputetët kanë miratuar rendin e punës për të proceduar me zgjedhjen e kryetarit të Kosovës dhe të Qeverisë së Kosovës.

Zotëri Krasniqi i ka njoftuar deputetët se z. Sejdiu ka dhënë dorëheqje nga posti i kryetarit të Kosovës, kurse kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, Eqrem Kryeziu, në emër të koalicionit PDK-LDK e ka propozuar po z. Fatmir Sejdiu për kryetar të Kosovës.

Në emër të 25 deputetëve, të cilët e kanë mbështetur edhe me nënshkrime, deputeti i AAK-së, ka propozuar z. Naim Maloku për kundërkandidat për kryetar të Kosovës.

Në raundin e tretë të votimit të deputetëve, Fatmir Sejdiu është zgjedhur kryetar i Kosovës me mandat pesëvjeçar.

Më pastaj mandatarin e Qeverisë së Kosovës, Hashim Thaçi ka mbajtur një ekspozitë pra deputetëve dhe ka prezantuar Kabinetin e tij qeveritar, i cili edhe është miratuar me shumicë votash. Më pastaj Qeveria e Kosovës dhe betimin solemn para deputetëve të Kuvendit.

Me nga një fjalë rasti deputetëve u janë drejtuar, edhe kryeparlamentari Krasniqi, kryeadministratori Ryker, kryetari i Kosovës Sejdiu dhe kryeministri Thaçi.

Udhëheqësit e zgjedhur të Kosovës kanë falënderuar për besimin e dhënë dhe janë zotuar se do të punojnë bashkërisht për përparimin gjithëpërfshirës të



QEVERIA JEP BETIMIN SOLEMN

vendit dhe pavarësinë e Kosovës.

Zyrtarizim i vullnetit të qytetarëve të Kosovës për shtetin e pavarur dhe sovran në koordinim me vendet e demokracisë Veri-Atlantike

Duke iu drejtuar deputetëve , Jakup Krasniqi tha:” Ndihem i nderuar që sot po e marr një detyrë aq me përgjegjësi dhe të nderuar që të udhëheq Kuvendin e Kosovës, andaj më lejoni që sinqerisht t’ju falënderoj të gjithë Juve për besimin e dhënë.

I falënderoj qytetarët e Kosovës për besimin e dhënë në zgjedhjet e 17 nëntorit 2007 dhe mbështetjen e dhënë gjate gjithë jetës dhe aktivitetit tim dhe siguroj të gjithë qytetarët e Kosovës se angazhimi im do të vazhdoj të jetë në shërbim të tyre dhe të interesit të vendit për sot e nesër. Në mënyrë të veçantë, nga zemra dua t’i përhëndes te gjitha familjet që atdheut i dhuruan me të dashurit e tyre, e posaçërisht

Jasharët Legjendarë.

Angazhimi im do te jete në shërbim te institucionit që përfaqësojmë, në shërbim te institucionalizimit, të zhvillimit e të avancimit të demokracisë. Kemi për obligim që të vihemi në mbrojtje të vlerave, te kulturës e të traditës kombëtare, te vlerave të shoqërisë e të demokracisë evropërendimore, në kërkim të së cilës ishin breza të tërë të Kosovës. Mbrojtja e kushtetutshmërisë, e ligjeve dhe e Rregullores së Punës së Kuvendit tonë do të jetë në nivelin më të lartë të kodit të mirësjelljes parlamentare. Në punën time, në udhëheqje të Kuvendit të Kosovës do të respektoj fjalën e të drejtën e secilit nga Ju. Duke ju respektuar Juve , unë respektoj të drejtën e qytetarëve dhe votën e tyre të shenjtë që keni marrë secili nga ju. Në punën e Kuvendit, deputetët nuk do t’i ndaj në deputetë të pozitës e të opozitës.

Duke respektuar të drejtat e liritë

e qytetarëve, angazhimin e tyre për liri e demokraci, unë vazhdoj të respektoj të drejtat e komuniteteve jo shumicë që jetojnë në Kosovë dhe do të garantojë respektimin e barabartë të tyre edhe në punën e Kuvendit të Kosovës. Kontributin e komunitetit ndërkombëtar për ndihmën humanitare, për rindërtimin e vendit, për ndërtimin e institucioneve demokratike, për paqen dhe sigurinë që e kanë vendosur në Kosovë. Për jetën e lirë dhe perspektivën qe ia kanë kthyer vendit e popullit te Kosovës pa dallime etnike. Do ta ruaj dhe thelloj bashkëpunimin me të gjitha institucionet e BE-së dhe të SHBA-së , përkatësisht të OSBE-së dhe te NDI-së.

Jam i vetëdijshëm për vështirësitë e mëdha që i kemi përpara dhe të cilat duhet t’ i zgjidhim së bashku edhe me institucionet ndërkombëtare të instaluara edhe në Kosovë. Jam i bindur se kemi nevojë për besim e mirëkuptim të

gjerë dhe jo vetëm mes nesh që do të jemi në këtë Parlament.

Në vitin e parë të kësaj legjislativiteti do të ndodhë zyrtarizmi i vullnetit të qytetarëve të Kosovës për shtetin e pavarur dhe sovran në koordinim me vendet e demokracisë Veri-Atlantike, të cilat po e mbështesin fuqishëm të drejtën tonë për mëvetësi. Ne me punën dhe angazhimin tonë të përditshëm, me përgjegjësi e përkushtim do të tregojmë e garantojmë se e meritojmë këtë mbështetje.

Edhe një herë Ju falënderoj për besimin e dhënë, ju ftoj për bashkëpunim dhe shpreh gatishtësinë për punë serioze dhe të sinqertë në shërbim të gjithë qytetarëve dhe vendit tonë”.

Fatmir Sejdiu, iu drejtua të pranishmëve me këto fjalë :”Më lejoni para së gjithash që t’ju shpreh mirënjohjen dhe falënderimin tim të thellë për besimin që më dhatë

për të qenë edhe një mandat në krye të institucionit të Presidentit të vendit. Dua të zotohem para jush të nderuar deputetë dhe para qytetarëve të Kosovës se do të vihem me të gjitha fuqitë dhe dijen time në mbrojtjen dhe respektimin e ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë. Kujdes të veçantë do t’i kushtoj ruajtjes së unitetit demokratik të vendit dhe me gjithë energjinë do të angazhohem për të mirën e gjithë qytetarëve të Kosovës, vendit tonë të dashur.

Sot, po përmbyllim një proces të rëndësishëm demokratik nëpër të cilin ka kapërcyer populli i Kosovës, mbi bazën e zgjedhjeve parlamentare të nëntorit 2007 dhe po hapim një kapitull të veçantë duke përfunduar procesin e konstituimit të institucioneve demokratike në mbështetje të vullnetit politik të popullit të Kosovës.

Kosova arriti me sukses të mbajë unitetin e saj veprues

Për të gjitha institucionet e Kosovës dhe Ekipin e Unitetit sfidë e veçantë ishte angazhimi për përmbylljen e procesit të bisedimeve për statusin politik - që është bërë në mënyrën më të mirë të mundshme - dhe në po të njëjtën kohë mbajtja e një procesi zgjedhor demokratik, i cili u përshkua me një konkurrencë të theksuar në prezantimin e programeve gjatë fushatës elektorale. Kosova arriti me sukses të mbajë unitetin e saj veprues dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e funksionimit demokratik të institucioneve të saj, duke iu falënderuar në radhë të parë përputhshmërisë së plotë të qëndrimeve të spektrit politik dhe institucional sa i përket çështjes themelore – pavarësisë së

Kosovës.

Jam i bindur se institucionet e reja të Kosovës; Presidenca, Qeveria dhe Kuvendi fuqishëm dhe me energji të përbashkët do të japin kontributin maksimal të tyre në zhvillimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të demokracisë në Kosovë.

Jam i bindur se të gjitha forcat politike do të mbajnë frymën e

Para së gjithash, para institucioneve të reja të Kosovës shtrohen disa detyra themelore, të cilat jam i bindur se me sukses do t’i përmbarojmë.

Institucionet e Kosovës; Presidenca Qeveria dhe Kuvendi si institucionet më të larta përfaqësuese dhe ekzekutive:

1. Do të përmbyllim me sukses procesin e pavarësimit të Kosovës në realizim të vullnetit legjitim të popullit të saj dhe do të miratojnë Kushtetutën e shtetit të ardhshëm të Kosovës.
2. Do të zgjerojnë korpusin legjislativ në përputhje me Pakon e Presidentit Ahtisari dhe me standardet më të larta bashkëkohëse ndërkombëtare, si dhe gjithë korpusin legjislativ të nevojshëm për të mbështetur funksionimin institucioneve dhe të mirëqenies së përgjithshme të qytetarëve.
3. Do të ndërmarin të gjitha veprimet e nevojshme që të përshpejtojnë integrimin e Kosovës në strukturat euroatlantike si orientim themelor i shtetit të Kosovës.

Kulturë e lartë politike

Qytetarët e Kosovës dhe të gjitha partitë politike, koalicionet, iniciativat qytetare dhe kandidatët e pavarur që garuan në këto zgjedhje, treguan pjekurinë e lartë politike duke e kapërcyer suksesshëm këtë provë të madhe dhe duke dëshmuar kulturë të lartë politike dhe shtetformuese. Rrallë mund të gjendet një vend i cili ka kapërcyer me kaq dinjitet dhe me sukses sfidat e shumta paralele, siç bëri Kosova në këta muajt e fundit.

bashkëpunimit të frytshëm për të siguruar edhe më tutje funksionimin demokratik të institucioneve të Kosovës në të mirë të interesave të vendit. Po kështu, institucionet e Kosovës do të bashkëpunojnë ngushtë me pranimë ndërkombëtare civile dhe ushtarake në periudhat tepër të rëndësishme dhe vendimtare në të cilat po hyn vendi ynë.

Më lejoni të theksoj se Kosova e pavarur, e cila shpejt do të marrë edhe bekimin ndërkombëtar, do të jetë thellësisht e përkushtuar në bashkëpunimin dhe zhvillimin e një fqinjësie të mirë me të gjitha vendet e rajonit duke qenë faktor stabiliteti për këtë pjesë të Evropës dhe të botës. Në veçanti, institucionet e Kosovës janë të përkushtuara që të mbrojnë dhe garantojnë liritë dhe të drejtat e të gjitha grupeve etnike joshumicë. Kujdes i veçantë do t'i kushtohet mirëqenies dhe integritetit të plotë të komunitetit serb në Kosovë. Institucionet e reja të Kosovës synojnë një Kosovë, shtëpi dhe mundësi e barabartë për të gjithë. Duke qenë i bindur në përkushtimin e institucioneve të Kosovës për ta çuar përpara shtetin e ri të Kosovës, më lejoni që t'ju dëshiroj shëndet dhe punë të mbarë e të suksesshme në përmbushjen e mandatit dhe objektivave tuaj. Jam i sigurt se së bashku do t'ia dalim”.

Ne jemi duke u përgatitur që në fillim të pjesës së parë të këtij viti ta bëjmë Kosovën të pavarur dhe sovranë

Kryeministri Hashim Thaçi iu drejtua të pranishmëve me këto fjalë:” Ne jemi duke u përgatitur që në fillim të pjesës së parë të këtij viti ta bëjmë Kosovën të pavarur dhe sovranë.

Sot ndjehem i nderuar, që para

jush dhe qytetarëve të Kosovës kam rastin të paraqes fjalimin ekspozitë të Qeverisë së Kosovës.

Më lejoni që në fillim t'i falënderoj të gjithë qytetarët e Kosovës për mbështetjen e dhënë, si dhe kryetarin e Kosovës për dhënien e mandatit për formimin e qeverisë, detyrë kjo që me kënaqësi e kam pranuar dhe me nder e përgjegjësi do ta ushtroj.

Ky vit që sapo filluam sjell para nesh, si vend dhe popull, jo vetëm ballafaqime dhe sfida të shumta, por edhe shpresën dhe besimin e ringjallur me plot mundësi për të ecur përpara.

Është e vërtetë, sot ndodhemi në udhëkryqin më të rëndësishëm të historisë sonë të re. Ne jemi duke u përgatitur që në fillim të pjesës së parë të këtij viti ta bëjmë Kosovën të pavarur dhe sovranë. Vend të mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët e saj. Të drejtat e minoritareve do të respektohen dhe garantohen përmes angazhimeve afirmative, të garantuara edhe me Kushtetutë.

Për Kosovën e pavarur dhe demokratike populli ynë është i bashkuar si asnjëherë më parë. Ne jemi në një krah dhe të koordinuar ngushtë me miqtë tanë: Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimin Evropian dhe NATO-n. Ëndrrën dhe të drejtën tonë do ta bëjmë realitet. Kosova do bëhet pjesë e familjes së popujve të lirë të botës. Politika e Qeverisë së Kosovës çdo herë do të mbetet e rrënjësuar në të drejtën e popullit tonë. Kosova do të jetë e pavarur! Mirëpo, nuk duhet të harrojmë se pavarësia e shumëpritur nuk do t'i zgjidhë të gjitha problemet e vendit tonë.

Bashkë me pavarësinë do të vijmë edhe shumë sfida tjera, me të cilat duhet të ballafaqohemi.

Është obligim ynë ndaj qyte-

tarëve që të krijojmë lidhë të ri dhe të fuqishëm, i cili do të punojë me nder dhe përkushtim të lartë për të bërë shtetin tonë të ri të respektuar.

Agjenda të cilën po e shpalos sot para jush, qëllim parësor ka ndryshimet reale e të menjëhershme, gjithëpërfshirëse dhe rrënjësore.

Pikërisht ato ndryshime në të cilat besuan, i kanë kërkuar dhe që i presin qytetarët tanë. Qytetarët tanë me të drejtë janë duke pritur dhe janë duke vëzhguar me kujdes. Ata kanë kërkuar dhe janë përcaktuar për ndryshime. Ata janë duke pritur veprime konkrete dhe të menjëhershme. Prandaj duke filluar këtu, që nga sot, ne duhet t'i përmbushim pritjet e tyre, që janë edhe zotimet tona. Agjenda e Qeverisë së Kosovës për reforma dhe ringjallje është specifike dhe e gjerë. Ajo i qartëson prioritetet, mirëpo me lejoni të sqaroj, ajo nuk paraqet listë të të gjitha problemeve, që do të zgjidhen gjatë vitit 2008.

Sfidat tona janë të shumta, mirëpo qëllimet tona janë të fokusura. Së bashku duhet të fillojmë punën e gjithanshme për ndërtimin e vendit tonë të ri.

Në javët vijuese, unë ne emër të qeverisë së Kosovës do ta prezentoj para qytetarëve tërë projektin gjithëpërfshirës për Reforma Ekonomike. Ky plan do të fillojë ta ngjallë ekonominë kosovare, me qëllim që ta shpjerë vendin tonë në epokën e re të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të mundësive.

Kjo epokë ndërtohet duke krijuar një klimë në të cilën investitorët, jo vetëm që mund të vijnë dhe të investojnë në Kosovë, por ata mund të operojnë pa probleme, t'i zgjerojnë bizneset e tyre dhe të krijojnë vende të reja pune. Në

këtë përpjekje do të udhëhiqemi me një disiplinë, transparencë dhe kujdes të madh financiar.

Ne do të sigurohemi që projektet tona kapitale të parapara për këtë vit dhe vitet vijuese të financohen ashtu siç duhet dhe që buxheti të jetë në përputhje me këto projekte.

Prandaj, Qeveria e re Kosovës do ta bëjë një rishikim të tërësishëm të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës për vitin 2008.

Zotohemi për krijimin e zonave industriale të cilat do ta stimulojnë rritjen ekonomike

Ne do të jemi të bashkuar në qëllimin tonë për të shënuar rritje ekonomike, duke u pajtuar për uljen e tatimit për biznese, që është më e larta në rajon. Në gjendjen e tanishme, motivi i investitorëve për të ardhur dhe investuar në Kosovë është shumë i ulët. Ulja e kësaj takse do të dërgojë mesazh të qartë për tërë botën se Kosova është e hapur për biznes.

Veprimi tjetër që duhet të bëjmë së bashku është sigurimi i kredive me kamata të ulëta dhe afatgjata. Ato kredi do të jenë të përshtatshme për bizneset, dhe do ta vërtetojnë faktin se në Kosovë mund të krijohen vende të reja pune.

Të shkojmë në hap më tutje – zotohemi për krijimin e Zonave Industriale të cilat do ta stimulojnë rritjen ekonomike.

Përmes lehtësirave të ndryshme tatimore, të dizajnuara për t'i tërhequr bizneset e reja në Kosovë, bizneseve ekzistuese do t'u krijojmë mundësi të zgjerimit dhe të krijimit të më shumë vendeve të punës. Që ta dëshmojmë se Kosova është e hapur për biznes, ne duhet të ballafaqohemi me sfidat më të mëdha

Fond Nacional për Arsim

Ju ftoj që ta fillojmë realizimin e qëllimit tonë qysh sot - ta bëjmë Kosovën lider rajonal në përgatitjen e studentëve për karrierë në lëmin e matematikës, shkencës dhe teknologjisë informative. Projekti ynë shpalos pakon e detajuar për reformat në arsim, e cila do të sigurojë mundësi të reja për studentët tanë dhe do t'i sigurojë prindërit se fëmijët e tyre, fëmijët tanë do të kenë mundësi ta vënë në funksion potencialin e tyre intelektual. Do ta fillojmë këtë projekt të madh duke krijuar Fondin Nacional për Arsim, duke i ngritur pagat e mësimdhënësve, duke i motivuar ata me shpërblime për arritjet në punë. T'i ndihmojmë lokalitetet tona duke ndërtuar shkolla të reja dhe kështu të lehtësojmë gjendjen e rëndë ekzistuese. Përveç kësaj, do të fillojmë menjëherë me vendosjen e

qendrave kompjuterike në shkollat tona, me qëllim që jo vetëm t'i lidhim shkollat ndërmjet veti, por edhe me shtetet tjera moderne të botës.

Do të krijojmë një sistem të vlerësimit të dijes për nxënësit dhe do të punojmë intensivisht në licencimin e arsimtarëve.

Do të krijojmë një sistem universitar të shekullit të 21-të, i cili siguron kuadro të specializuara në matematikë, shkencë dhe teknologji informative. Një sistem i cili iu mëson studentëve tanë shkathtësitë e domosdoshme për të arritur suksese në ekonominë e avancuar të së nesërme. Së bashku ta bëjmë arsimin një aset të dobishëm për gjeneratat e ardhshme. T'i fuqizojmë fëmijët tanë që ata të korrin suksese në karrierën e tyre, inovatorë dhe kreatorë të së nesërme.

ekonomike: Energjinë dhe Infrastrukturën. Përkushtimi ynë për energjinë dhe infrastrukturën do të jetë konkret dhe serioz. Mungesa e energjisë së vazhdueshme do të konsiderohet nga qeveria e Kosovës si një krizë nacionale.

Prandaj, qeveria do të përgatitë një pako reformash të gjithanshme për t'i tejkaluar problemet ekzistuese, për të garantuar furnizim të rregullt dhe normal me energji.

Unë kërkoj ndihmën tuaj për të gjetur zgjidhje të shpejta për problemet ekzistuese. Në këtë as-

pekt duhet të jemi inovativ:

Do t'i studiojmë të gjitha mundësitë alternative të energjisë, duke u nisur nga energjia diellore e deri tek ajo e erës, që të sigurohemi për përmbushjen e nevojave tona.

Do të vazhdojmë përpjekjet për ta bërë Kosovën vendin më të gjelbër në Evropën Lindore. E gjithë bota është duke u përballur me dilemën se "ku do ta gjejmë energjinë e domosdoshme për furnizimin e ekonomisë globale të shekullit të 21-të, pa shkaktuar dëme të pariparueshme për ambientin tonë natyror?" Përse të mos

bëjmë përpjekje që ta bëjmë Kosovën një vend që mund të japë përgjigje në këtë çështje? Ju ftoj që Kosovën ta bëjmë një qendër rajonale të pastër për kërkime në lëmin e energjisë, për zhvillim, prodhim dhe hapje të vendeve të reja të punës. Të sigurohemi që t'i tërheqim kompanitë nga e gjithë bota, të cilat merren me prodhimin e energjisë së pastër dhe rigjeneruese për të ardhmen.

Krijimi i rrjetit infrastrukturor ndërkufitar efikas do të jetë gjithashtu prioritet i Qeverisë së Kosovës. Duke filluar nga rrugët e deri tek hekurudhat, ne duhet të punojmë së bashku që t'i modernizojmë ato dhe të ndërtojmë infrastrukturë të re për ta lidhur vendin tonë në çdo kënd. Do ta integrojmë infrastrukturën tonë në rrjetin e transportit ndërkombëtar dhe të ecim drejt implementimit të standardeve evropiane.

Projekti ynë nuk synon vetëm uljen e shpenzimeve për bizneset, por edhe rritjen e konkurrencës, stimulimin e investimeve dhe krijimin e vendeve të punës.

Në ditët e sotme, mundësitë varen nga fuqia e dijes, prandaj kompanitë janë në gjendje të udhëtojnë në çdo vend të botës për ta gjetur këtë fuqi. Investojnë aty dhe lidhen me të.

Do të fillojmë t'i implementojmë prioritetet tona në fushën e arsimit, me qëllim që të ballafaqohemi me sukses me kërkesat e shekullit 21. Fokusimi në ekonomi, energji, infrastrukturë dhe arsimit do të na mundësojë që ta rrisim buxhetin tonë të kufizuar.

Fund i ciklit të vazhdueshëm të humbjeve, mashtrimeve dhe abuzimeve me paratë e qytetarëve tanë

Kjo rritje na lejon pastaj që të

Përbërja e Qeverisë

Kryeministër - Hashim Thaqi (PDK)
Zëvendëskryeministër- Hajredin Kuqi (PDK), Ramë Manaj (LDK)
Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit - Fatmir Limaj (PDK)
Zv/ministër - Adem Grabovci (PDK)
Ministria e Ekonomisë dhe Financave - Ahmet Shala (PDK)
Zv-ministër Bedri Hamza (PDK)
Ministria e Energjetikës dhe Minierave - Justina Pula-Shiroka (PDK)
Zv/ministër - Blerim Rexhaj (PDK)
Ministria e Arsimit, Shkencës dhe e Teknologjisë- Enver Hoxhaj (PDK)
Zv/ministër - Agim Hyseni (PDK)
Ministria e Shërbimeve Publike - Arsim Bajrami (PDK)
Zv/ministër - Rifat Blakaj (PDK)
Ministria e Shëndetësisë - Alush Gashi (LDK)
Zv/ministër - Mubera Mustafa (LDK)
Ministria e Dejtësisë - Nekibe Kelmendi (LDK)
Zv/ministër - Arsim Janova (LDK)
Ministria e Punëve të Brendshme - Zenun Pajaziti (PDK)
Zv/ministër - Fatmir Xhelili (PDK)
Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Idriz Vehapi (PDK)
Zv /ministër - Sylë Sylanaj (PDK)
Ministria për Tregti dhe Industri, Lutfi Zharku (LDK)
Zv- ministër Naser Osmani (LDK)
Ministria për Pushtetin Lokal - Sadri Ferati (LDK)
Zv/ministër - Shpend Tërdeva (LDK)
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe e Sporteve - Skender Hyseni (LDK)
Zv/ministër - Lirije Kajtazi (LDK)
Ministria për Ambient dhe Planifikim Hapësinor - Mahir Yagcilar (KDTP)
Zv/ministër - Emin Krasniqi (PDK)
Ministria për Kthim dhe Komunitete - Boban Stanković
Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale - Nenad Rashić
Zv/ministër – Gjergj Dedaj

koncentrohemi në programet sociale, për të cilat vendi ka aq shumë nevojë. Derisa vazhdojmë të ecim përpara së bashku, do t'u sigurojmë qytetarëve tanë sistem shëndetësor të nivelit të parë dhe të fillojmë krijimin e një sistemi

në të cilin të gjithë qytetarët do të kenë sigurime shëndetësore, qoftë private apo publike. Zotohemi sot, që qeveria jonë do t'i kushtojë kujdes të madh të moshuarve dhe do ta reformojë fondin pensional. Me qëllim që nga ai fond

të bëhen investime, dhe nga ai të mundësohen lehtësime për sigurimin e barnave si dhe sigurimin shëndetësor për të moshuarit. Të gjitha këto iniciativa do të jenë të pakuptimta në rast se nuk do të kemi qeveri të hapur dhe transparente. Unë dua ta nxjerr qeverinë nga mjegulla dhe ta bëj atë të përgjegjshme para qytetarëve të cilëve ajo do të duhej t'u shërbente. Unë zotohem se do t' i jap fund ciklit të vazhdueshëm të humbjeve, mashtrimeve dhe abuzimeve me paratë e qytetarëve tanë. Do t' i mbetem besnik besimit të dhënë nga qytetarët. Do të kërkoj nga secili ministër që ta bëjë të njëjtin zotim.

Lufta kundër korrupsionit do të jetë e ashpër dhe me zero tolerancë ndaj kujtdo dhe kurdoherë. Prandaj kërkoj mbështetjen tuaj, të institucioneve përgjegjëse vendore dhe të gjithë qytetarëve të Kosovës. Në kohët që vijnë Kosova do të formësojë institucionet e veta demokratike dhe do të funksionojë si një shtet i plotë në tërë territorin e saj. Unë kërkoj unitetin tuaj të vazhdueshëm, besimin dhe mirëkuptimin. Sfidat me të cilat ballafaqohemi nuk janë të pakta dhe zgjidhjet nuk do të mund të jenë aq të lehta dhe të shpejta. Programi që do të prezantoj, do të fillojë të zbatohet në praktikë që nga sot, por nuk do të mund të përfundojë gjatë vitit të parë të kësaj qeverie. Do të kemi udhëtim të gjatë bashkërisht. Pra, bashkohuni me mua që të fillojmë këtë udhëtim që nga sot, ta fillojmë të bashkuar në shpirtin e shpresës, vendosmërisë dhe të mundësive.

Ju ftoj sot që ta votoni këtë agjendë, për këtë qeveri dhe për qytetarët të cilët do të na ndihmojnë në rrugën tonë. Vota juaj u dërgon mesazhin e qartë atyre që i përfaqësoni. Ju u keni thënë atyre se jeni të gatshëm që të jeni liderë të fuqishëm ashtu siç ju duan, që të bëni ndryshimet e vërteta që ata i kërkojnë dhe ta ndërtoni vendin e ri ashtu siç ata e meritojnë.

Pas përmbylljes së seancës së sotme zotërinjtë Jakup Krasniqi dhe Kolë Berisha kanë bërë pranim-dorëzimin simbolik të detyrës së kryetarit të Kuvendit të Kosovës.

DY PËRFAQËSUES TË KUVENDIT TË KOSOVËS MORËN PJESË NË KONFERENCËN NDERKOMBËTARE NË LUBJANË

Viti 2008 - vendimtar për Ballkanin Perëndimor

Deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Zylfije Hundozi dhe Xhezair Murat kanë folur në këtë Konferencë. - Shumica e folësve e kanë mbështetur pavarësinë e Kosovës

Në Konferencën ndërkombëtare në Lubjanë, në temën "2008: vit vendimtar për Ballkanin perëndimor", në mesin e 200 zyrtarë të lartë të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe të shteteve anëtare të Unionit Evropian, kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e nga Parlamenti i Kuvendi i Republikës së Kosovës: znj. Zylfije Hundozi, kryetare e Komisionit për Integritet Evropian dhe Xhezair Murat, nënkryetar i komisionit.

Gjatë diskutimeve vëmendje të posaçme i është kushtuar stabilitetit në Ballkanin Perëndimor pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës.

Shumica e folësve, në mesin e të cilëve ishin politikanë eminent, sociologë, politikologë dhe analistë politik, kanë dhënë mendime pozitive duke thënë se pavarësia e Kosovës paraqet një hap përpara për stabilizimin e situatës së sigurisë, asaj ekonomike dhe sociale në këtë pjesë të Evropës. Konferenca është zhvilluar në katër sesione, kurse në njërin prej sesionve me titull "Ballkani Perëndimor pas pavarësisë së Kosovës" ekspozenë e ka paraqitur përfaqësuesja e Kosovës, znj. Zylfije Hundozi, e cila ekspozë është mirëpritur nga shumë pjesëmarrës dhe ka ngjallur

një debat të gjallë dhe të frytshëm. Në ekspozë është paraqitur qëndrimi pozitiv i shtetit të Kosovës për bashkëpunim regional dhe integritet Evropian.

Pyetjet e pjesëmarrësve janë përqendruar kryesisht për realitetin e ri të krijuar në Kosovë dhe vizionin e kosovarëve për të ardhmen e regjionit, gjegjësisht marrëdhëniet me fqinjët, sidomos me Serbinë dhe Shqipërinë.

Në pyetjet e shumta për respektimin e të drejtave të njeriut, gjegjësisht të pakicave e sidomos asaj serbe në shtetin e ardhshëm të Kosovës pjesëmarrësit janë njoftuar për ligjet të cilat kanë dalë nga Plani i Ahtisarit e që kanë të bëjnë me të drejtat e minoriteteve.

Anëtarë i Kryesisësë Kuvendit të Kosovës, dhe nënkryetar i Komisionit për Integritet Evropian, Xhezair Murat, në diskutimin e vet ka treguar se minoritetet në Kosovë gëzojnë të drejta të barabarta dhe nuk dallohen në asnjë mënyrë nga popullata shumicë.

Parlamentarët kosovarë, pjesëmarrës në Konferencën ndërkombëtare në Lubjanë, shprehen të bindur se vizita në Slloveni është një kontribut shtesë për përkrahje më të madhe Republikës së Kosovës drejt rrugës së saj në Bashkimin Evropian.

Kosova do të funksionojë në tërësinë e saj territoriale

SHBA-të ta mbështesin Kosovën për anëtarësim në mekanizmat financiar ndërkombëtarë. - Sa më të forta dhe më funksionale të jenë institucionet e Kosovës, aq më shpejt do të integrohen minoritetet

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Jakup Krasniqi, ka pritur sot ndihmëssekretarin e Shtetit Amerikan, Daniel Fried, me të cilin ka biseduar për zhvillimet në Kosovë pas shpalljes së pavarësisë së vendit dhe për punën që po bën Kuvendi i Kosovës për funksionalizimin e shtetit të ri të Kosovës.

Kryeparlamentari Krasniqi ka shprehur konsideratat më të thella për qeverinë dhe popullin amerikan, të cilët kanë meritat më të mëdha për pavarësinë e Kosovës, prandaj populli i Kosovës dhe institucionet e saj do t'u jenë përjetë mirënjohës, ka theksuar kreu u legjislativit të vendit. Ai më pastaj ka folur për punën e Kuvendit të Kosovës, pas shpallje së pavarësisë së vendit, duke theksuar miratimin e një sërë ligjesh, në mesin e të cilave edhe nëntë ligje që burojnë nga Plani i Ahtisarit për Kosovën. Krasniqi ka pohuar se me procedurë të shpejtë do të miratohen edhe projektligje të tjera nga ky plan, sikurse do të miratohet së shpejti edhe Kushtetuta e Kosovës. Ai ka kërkuar që SHBA-të ta ndihmojnë anëtarësimin e Kosovës në Bankën Botërore dhe Fondin Monetar Ndërkombëtar, për të siguruar një zhvillim më të shpejtë ekonomik të vendit, si dhe për anëtarësim në OKB.

“Jam shumë i kënaqur që e vizitoj Republikën e Kosovës dhe që e



shoh këtë flamur të Kosovës, i cili është aq i bukur dhe aq shprehës për realitetin e vendit tuaj” ka filluar bisedën ndihmëssekretari i Shtetit Amerikan, Daniel Fried, i cili ka përcjell përshëndetjet e sekretares amerikane të shtetit, Kondoliza Rajs, për institucionet e Kosovës. Ai ka shprehur kënaqësinë që shpallja e pavarësisë së Kosovës nuk është shoqëruar me manifestime nacionaliste dhe triumfaliste, ndërkohë që në ndonjë vend tjetër u është vënë flaka ambasadave të vendeve perëndimore. Kjo, ka thënë Fried, tregon se sa të drejtë kemi pasur që e kemi ndihmuar dhe njohur shtetin e ri të Kosovës. Ai ka lavdëruar përkushtimin e Kuvendit dhe të Qeverisë së Kosovës për miratimin e Kushtetutës dhe të ligjeve nga Plani i Ahtisarit, ndërkaq, e ka garantuar kryepar-

lamentarin Krasniqi se Kosova do të funksionojë në tërësinë e saj territoriale.

Fried ka premtuar gjithashtu se SHBA-të do ta mbështesin Kosovën për anëtarësim në mekanizmat financiarë ndërkombëtarë, kurse ka shprehur bindjen e tij të thellë se sa më të forta dhe më funksionale të jenë institucionet e Kosovës, aq më shpejt do të integrohen minoritetet në shoqërinë kosovare.

“Ne jemi krenar që jemi pjesë e kësaj vepre dhe tani qëllimi është që Kosova të shkojë në Evropë”, ka thënë ndihmëssekretari i Shtetit Amerikan, Daniel Fried, i cili ka theksuar se sa më shumë që Kosova të vazhdojë në rrugën demokratike dhe sa më shumë të bëjë për minoritetet, aq më të fortë do t’i bëjë miqtë e saj të dëshmuar.

Në Kosovë po fryn një erë e re demokratike dhe prosperuese drejt integritimeve evropiane

Kosova e pavarur në ecje drejt Brukselit do të jetë burim paqeje dhe prosperiteti. - Proceset demokratike që po zhvillohen në Kosovë janë të palëkundshme, ajo ka kapacitete të duhura shtetformuese, theksoi para deputetëve, presidenti i Shqipërisë Bamir Topi



Në shenjë të vizitës së Presidentit të i Shqipërisë prof.dr. Bamir Topi në Kosovë, Kuvendi i Kosovës mbajt një seancë solemne, të kryesuar nga kryetari i Kuvendit Jakup Krasniqi, në të cilën shprehu mirënjohjen dhe respektin për tërë kontributin e Shqipërisë që po jep në proceset e gjithëmbarshme të Kosovës, që çojnë drejt pavarësisë së vendit. Duke përshëndetur presidentin e Shqipërisë dhe bashkëpunëtorët e tij, kryeparlamentari Krasniqi tha se vizita e presidentit Topi kondicionon me procesin e gjithëmbarshtëm të konsolidimit të institucioneve të Kosovës të dala nga zgjedhjet e 17 nëntorit, zgjedhje këto që ishin një sprovë e suksesshme e demokracisë në Kosovë, të shoqëruara me kulturë të lartë demokratike sipas stan-

dardeve më të larta. Legjislatura e Tretë, tha më tutje Krasniqi, përfaqëson edhe përbërjen shumë etnike të Kosovës. Kosova tani ndodhet në fazën e shpalljes së pavarësisë, e cila po mbështetet nga SHB-të, BE-ja dhe shumica e shteteve të KS të OKB-së. Pavarësimi i Kosovës do ta bëjë Kosovën shoqëri tërësisht të lirë dhe sovraane, për të gjithë qytetarët e saj, duke u shndërruar në faktor paqeje e stabiliteti drejt një të ardhme evropiane. Në Kosovë po fryn një erë e re demokratike dhe prosperuese. Në të gjitha këto procese e të arritura në formimin e shtetit të Kosovës Shqipëria ka dhënë dhe po jep një kontribut të veçantë, theksoi kryeparlamentari Krasniqi.

Në vijim deputetëve të Kuvendit, në mesin e të cilëve ishin edhe

personalitete të larta të institucioneve shtetërore, shkencore e kulturore, iu drejtua presidenti i Shqipërisë, prof.dr. Bamir Topi, i cili pasi përcolli përshëndetjet më të përzemërta dhe mbështetjen e Shqipërisë për Kosovën dhe të gjitha institucionet e saj të dala nga zgjedhjet e paradokohshme, tha se është shumë i lumtur që gjendet në Kosovë, në këto ditë vendimtare nëpër të cilat po kalon ajo. Në këtë frymë ai shprehu edhe përgëzimet për gjithë qytetarët për këto zgjedhje të suksesshme dhe të pranuar ndërkombëtarisht. Kjo është dëshmi, theksoi ai, se proceset demokratike që po zhvillohen në Kosovë janë të palëkundshme, se Kosova ka kapacitete të duhura shtetformuese. Kosova është e gatshme, që në koordinim me bashkësinë ndërkombëtare të shpallë pavarësinë, ndaj çdo zgjatje në procesin e pavarësimit do të ishte e pafalshme. Kosova e pavarur në ecje drejt Brukselit do të jetë burim paqeje dhe prosperiteti.

Kryesia e Kuvendit të Kosovës nën udhëheqjen e Jakup Krasniqit organizoi një pritje të veçantë përshëndetëse për presidentin Bamir Topi. Me këtë rast presidenti Topi shprehu urimet për zgjedhjen e institucioneve demokratike të vendit dhe garanto mbështetjen e Shqipërisë për Kosovën.

Përkushtimin i veçantë i parlamentarëve për të ecur përpara në ndërtimin e shtetit ligjor

Partneriteti me shtetet e Bashkimit Evropian, e posaçërisht me SHBA-të, ka pasur dhe do të ketë një rëndësi të veçantë në progresin e mëtejshëm të Kosovës



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Jakup Krasniqi, bashkë me shefat e grupeve parlamentare, kishte sot një takim me një delegacion të kongresistëve amerikanë, në përbërje: Wayne Gilchrest, David Dreier, Judy Biggert, Joe Wilson, Rush Holt, Lois Capps, David Price, Earl Pomeroy, Adam Schiff. Ky delegacion, i cili ishte i shoqëruar edhe nga shefja e Zyrës së SHBA-ve në Prishtinë, Tina Kajdanov, është një Komision i cili u ofron ndihmë shteteve në tranzicion.

Pas përshëndeti delegacionin, Kongresin e Amerikan, presidentin Bush, sekretaren e Shtetit, Kondoliza Rajs dhe mbarë pop-

ullin amerikan për mbështetjen e pakursyer që i kanë dhënë e po i japin formimit dhe ndërtimit demokratik të shtetit më të ri në botë, Republikës së Kosovës, kryetari i Kuvendit të Kosovës foli në mënyrë mjaft të shkoqitur për përbërjen e Parlamentit të Kosovës, si dhe për proceset më të reja në Kosovë, siç ishin zgjedhjet dhe shpallja e pavarësisë së Kosovës. Në vijim kryeparlamentari Krasniqi i njoftoi kongresmenët amerikanë edhe me dinamikën e aprovimit të ligjeve gjatë muajit të fundit nga ana e Kuvendit të Kosovës. Përkritazi me këtë ai tha se brenda një kohe shumë të shkurtër parlamentarët e Kosovës aprovuan 19 ligje nga

Pakoja e Ahtisarit me procedurë të shpejtuar, si dhe 28 ligje të tjera në lexim të parë. Një trajtim i veçantë në këto ligje iu jepet pozitës së minoriteteve, e posaçërisht minoritetit serb. Është për t'u theksuar se ligjet nga Pakoja e Ahtisarit janë aprovuar sipas mocionit për procedurë të shpejtuar të tyre nga dy të tretat e deputetëve. Në këtë vështrim u dëshmuar një unitet i plotë i grupeve parlamentare. Angazhimi i gjithëmbarshtëm yni, tha kryeparlamentari Krasniqi, është që të krijojmë një ambient të qetë për të gjithë, duke lënë prapa të kaluarën, për të ndërtuar një të ardhme sa më të mirë për të gjithë, për t'ua lënë trashëgim

pasardhësve tanë.

Në diskutimet e tyre Xhezair Murati, Ibrahim Makolli, Ramë Buja, Lutfi Haziri, Lulzim Zeneli dhe Ardian Gjini, theksuan përkushtimin e veçantë të grupeve që përfaqësonin për të ecur përpara në ndërtimin e shtetit ligjor e me demokraci të qëndrueshme të shtetit të Kosovës. Në tërë punën rreth aprovimit të ligjeve që është bërë ditëve të fundit nuk është hetuar se Parlamenti i Kosovës ka opozitë, sepse deputetët pa dallim partie ishin të vendosur për të kompletuar infrastrukturën ligjore, sidomos kur është fjala për ligjet që dalin nga Pakoja e Ahtisarit. Si kryeparlamentari, ashtu edhe të gjithë shefat e grupeve parlamentare, ishin të një mendimi se partneriteti me shtetet e Bashkimit Evropian, e posaçërisht me SHBA-të, ka pasur dhe do të ketë një rëndësi të veçantë në progresin e mëtejshëm të Kosovës. Në këtë frymë ata theksuan edhe sfidat tjera me të cilat do të ballafaqohet Kosova, sidomos në aspektin ekonomik, lëmë ky që është vështirë të përballohet pa ndihmën e SHBA-ve dhe të BE-së. Angazhimi ynë, theksuan ata, do të tregojë se sa e drejtë ka qenë përkrahja e Kosovës gjatë gjithë proceseve të deritashme të SHBA-së, të BE-së dhe shteteve tjera demokratike.

Duke folur rreth nevojës së përfshirjes së serbëve në jetën institucionale dhe atë shoqërore në Kosovë, kryeparlamentari Krasniqi theksoi se pjesëmarrja e serbëve po pengohet nga Beogradi, i cili po i kërcënon ata.

Kongresistët amerikanë përgëzuan parlamentarët dhe mbarë qytetarët e Kosovës për gjithë këto të arritura, sidomos kur është fjala për përgjegjësinë e lartë për ndërtimin e shtetit të Kosovës, për tolerancën, dëshirën për të punuar afër e afër me minoritetet, duke lënë anash të kaluarën e duke u angazhuar për një të ardhme sa më të mirë. Ata vlerësuan shumë lart, pjekurinë e madhe, sidomos përmbajtjen që tregoi populli i Kosovës në këto kohë plot sfida, duke shprehur dëshirën që kjo vetëpërmbajtje të vazhdojë edhe më tutje. Ata njëkohësisht u shprehën të impresionuar me dinamikën e aprovimit të ligjeve nga Pakoja e Ahtisarit.

KRYEPARLAMENTARI KRASNIQI BASHKË
ME KRYESINË PRET NJË DELEGACION
PARLAMENTAR NGA ESTONIA

Në Estoni është pritur me gëzim të madh Deklarata e Pavarësisë së Kosovës

Dy vendet respektive kanë histori të ngjashme, por edhe synime të njëjta demokratike. - Do ta mbështesim Kosovën në shumë plane dhe do të vazhdojmë të bëjë avokatin e saj për njohjen edhe nga vendet e tjera. - Brenda pak ditësh do të miratohet edhe Kushtetuta e vendit. - Interesim për bashkëpunim të ndërsjellë për shumë fusha të jetës, sidomos në planin e bashkëpunimit ekonomik dhe të investimeve estoneze në Kosovë

Në takimin e përbashkët që sot udhëheqja e Kuvendit të Republikës së Kosovës (kryeparlamentari Krasniqi dhe anëtarët e Kryesisë) ka pasur sot me delegacionin parlamentar nga Estonia, i prirë nga z. Hannes Astok, në të cilin merrnin pjesë edhe anëtarët e Komisionin Parlamentar për Punë të Jashtme, është biseduar për zhvillimet në Kosovë pas pavarësisë së vendit dhe për bashkëpunimin e ndërsjellë të të dyja vendeve, të cilat, siç u tha në takim, kanë histori të ngjashme por edhe synime të njëjta demokratike.

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Jakup Krasniqi, duke i dëshiruar mirëseardhje delegacionit parlamentar nga Estonia, ka falënderuar për mbështetjen e vazhdueshme të Estonisë për Kosovën dhe sidomos për njohjen, nga të parat vende të shtetit të pavarur

të Kosovës. Krasniqi në vazhdim ka folur për konstituimin e mekanizmave punues dhe për punën e madhe që po bëhet për miratimin e ligjeve, rreth 40 sish për një fazë shumë të shkurtër, nëntë nga të cilat burojnë nga Pakoja e Ahtisarit. Ai theksoi se brenda pak ditësh do të miratohet edhe Kushtetuta e vendit, e cila vë bazamentin e shtetit demokratik të Kosovës, me të gjitha garancitë për zhvillimin e papenguar të të gjithë qytetarëve të saj, e sidomos të minoriteteve.

Kryesuesi i delegacionit parlamentar nga Estonia, Hannes Astok, ua uroi kuvendarëve të Kosovës pavarësinë e vendit dhe u shpreh se në Estoni është pritur me interesim dhe gëzim të madh Deklarata e pavarësisë së Kosovës. Ai ka theksuar se Komiteti i Miqësisë Estoni-Kosovës, anëtarë të të cilit janë ai dhe anëtarët tjerë të dele-

gacionit, pas pavarësisë së Kosovës do të zgjerohet edhe më. Jemi në një fazë të rëndësishme të tranzicionit dhe duam që bashkë me Kosovën dhe vendet e tjera të ndërtojmë një Evropë prosperuese, ka thënë Astok. Ai ka premtuar se Estonia do ta mbështesë Kosovën në shumë plane dhe do të vazhdojë të bëjë avokatin e saj për njohjen edhe nga vendet e tjera.

Anëtari i kryesisë, Sabri Hamiti, ka shprehur konsidera për shtetin e Estonisë, duke shfaqur bindjen se Kosova ka nevojë për shumë përkrahje dhe shfaqur dëshirën që vendi ynë ta kalojë po aq shpejt rrugën për në integrimet europiane dhe euro-atlantike, siç e ka kaluar Estonia. Për këtë rrugë edhe kemi një konsensus në kuvendin e Kosovës, ka theksuar ai.

Botës ia kemi dëshmuar se e duam dhe e meritojmë pavarësinë, ka theksuar anëtari tjetër i Kryesisë, Xhavit Haliti, i cili ka vlerësuar sukseset e Estonisë për tu bërë anëtare e UE-së dhe NATO-s. Ai i ka garantuar parlamentarët estonezë se pavarësia e vendit do të jetë e mirë për të gjithë qytetarët e Kosovës, por edhe për vendet fqinje të saj. Ndërkaq, ka shfaqur kënaqësinë se në Kosovë janë të pranishme UE-ja dhe SHBA-të.

Anëtari i Komisionit për Punë të Jashtme, Dragisha Miriq, e ka përshëndetur vizitën e delegacionit estonez dhe i ka dëshiruar atij qëndrim të këndshëm në Kosovë. Edhe anëtarët e tjerë të delegacionit parlamentar estonez, Mart Nutt, Tovi Roivas dhe Jaanus Marandi, kanë shfaqur kënaqësinë e tyre për pavarësinë e Kosovës dhe janë angazhuar për bashkëpunim të ndërsjellë për shumë fusha të jetës, sidomos në planin e bashkëpunimit ekonomik dhe të investimeve estoneze në Kosovë.

NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT PËR PUNË TË JASHTME

Gjatë këtij viti Kosovën pritet ta njohin mbi njëqind shtete

Zëvendëskryeministri Kuçi raportoi për politikat e jashtme të Qeverisë së Kosovës. - Brenda kësaj kohe Kosova synon të hapë rreth njëzet përfaqësi diplomatike në vende të ndryshme të botës. Po përgatitet stafi për Ministrinë e Punëve të Jashtme



Mbledhja e sotme e Komisionit Parlamentar për Punë të Jashtme, e cila drejtohej nga Sabri Hamiti, kryetar i Komisionit, i ishte kush-tuar hapave të deritashëm që ka marrë Qeveria e Kosovës dhe veprimeve institucionale që duhet ndërmarrë për avancimin e diplomacisë së Kosovës: Në këtë mbledhje ishte ftuar edhe zëvendëskryeministri Hajredin Kuçi, i cili para anëtarëve të komisionit raportoi për politikat e jashtme të Qeverisë së Kosovës. Ndër objektivat e Qeverisë, në planin e politikave të jashtme të saj, Kuçi ka theksuar krijimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, për çka ka pohuar se po bëhen përgatitjet e duhura, përfshirë edhe përgatitjen e stafit për këtë ministri. (Projektligji për këtë MPJ-në do të shqyrtohet në seancën e nesërme). Ai është shprehur se Qeveria pret që gjatë këtij viti Kosovën ta njohin mbi njëqind shtete, kurse brenda pak ditësh shtetin e Kosovës do ta njohin shumica e vendeve të Konferencës Islamike. Brenda

këtij viti, ka thënë ai, Kosova synon të hapë rreth njëzet përfaqësi diplomatike në vende të ndryshme të botës.

Ndër objektivat të tjera të Qeverisë në planin e politikës së jashtme, Kuçi ka përmendur anëtarësimin e Kosovës në mekanizma të ndryshëm ndërkombëtarë, si: në Fondin Monetar Ndërkombëtar, në Bankën Botërore etj., si dhe përgatitjet për anëtarësim në UE, në NATO dhe në OKB.

Vëmendje të veçantë, ka theksuar Kuçi, Qeveria i jep komunikimit të rregullt dhe krijimit të besimit të ndërsjellë me Grupin Ndërkombëtar Drejtues për Kosovën (me seli në Vjenë), i cili jep fuqi Përfaqësuesit Civil Ndërkombëtar në Kosovë.

Zëvendëskryeministri Kuçi ka folur edhe për koordinimin e politikave të jashtme me kryetarin e Kosovës dhe me Komisionin Parlamentar për Punë të Jashtme, duke sugjeruar edhe krijimin e një Këshilli (ndërinstitucional) për politika të jashtme.

KRYEPARLAMENTARI KRASNIQI NË VIZITË ZYRTARE NË SHQIPËRI ME FTESË TË KRYEPARLAMENTARES , JOZEFINA TOPALLI

Shqipëria dhe Kosova po bëhen faktorë paqeje e stabiliteti në Rajon

Delegacioni parlamentar i Kosovës u takua me kryeparlamentaren Topalli, me presidentin Topi, kryeministrin Berisha, ministrin e Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Lulzim Basha dhe me përfaqësuesit e opozitës



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Jakup Krasniqi, i shoqëruar nga anëtarët e Kryesisë, Xhavit Haliti dhe Sabri Hamiti, filloi vizitën zyrtare në Shqipëri, me ftesë të kryetares së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, zonjës Jozefina Topalli.

Kryeparlamentari Jakup Krasniqi, takimin e parë e kishte me kryeparlamentaren Jozefina Topalli. Pas përgëzimeve për

pavarësinë e Kosovës , temë themelore e takimit të mbrëmshëm ishte thellimi i bashkëpunimit ndërparlamentar , që do të zhvillohet në kuadrin e gjerë të bashkëpunimit të shumanshëm ndërmjet dy shteteve. Me këtë rast, Jozefina Topalli, theksoi se Shqipëria dhe Kosova po bëhen faktorë paqeje e stabiliteti në Rajon. Kryeparlamentarja e Shqipërisë shtroi edhe një darkë për delegacionin nga Kosova.

Delegacioni i Kuvendit të Kosovës, i prirë nga kryeparlamentari Krasniqi , kishte edhe një takim me ministrin e Punëve të Jashtme të Shqipërisë , Lulzim Basha. Gjatë këtij takimi Lulzim Basha e njoftoi delegacionin e Kuvendit të Kosovës me një plan të kësaj ministrie për bashkëpunimin e mëtejshëm ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, në të gjithë lëmenjtë. Duke folur rreth procesit të njohjes ndërkombëtare të shtetit të ri të Kosovës , që sa vjen e shtohet nga bashkësia ndërkombëtare, si dhe për gatishmërinë e SHBA-ve dhe Bashkimit Evropian për të ndihmuar zhvillimin e proceseve aktuale në Kosovë, Lulzim Basha premtoi se Shqipëria, si pjesëmarrëse në Konferencën Islamike që do të mbahet së shpejti, do të angazhohet që të gjitha shtetet që e përbëjnë këtë Konferencë ta njohin pavarësinë e Kosovës .

Delegacioni parlamentar i Kosovës u takua edhe me presi-

dentin e Shqipërisë , z. Bamir Topi, si dhe me kryeministrin , z. Sali Berisha.

Menjëherë pas kthimit nga Tirana , kryeparlamentari Jakup Krasniqi, dha një prononcim për media në ambientet e Kuvendit të Kosovës. Duke folur për takimet që kishte gjatë kësaj vizite me kryeparlamentaren e Kuvendit të Shqipërisë, Jozefina Topalli, presidentin e Shqipërisë, Bamir Topi, kryeministrin Sali Berisha dhe ministrin e Punëve të Jashtme , Lulzim Basha , kryeparlamentari Krasniqi, theksoi se kjo vizitë ishte mjaft e frytshme. Temë bosht e kësaj vizite ishin format konkrete të bashkëpunimit ndërparlamentar, por edhe bashkëpunimi në fusha të tjera , si: bashkëpunimi ekonomik, arsimi, tregtia etj. Në kuadër të takimeve, theksoi Jakup Krasniqi, posaçërisht u fol për thellimin e bashkëpunimit në fushën e legjislacionit, si dhe këmbimin e përvojave në këtë fushë, pastaj funksionet e administratës, puna e komisioneve e lëmenj të tjerë të veprimtarisë së Kuvendit. Gjatë vizitës kryeparlamentari Krasniqi kishte takime edhe me përfaqësuesit e opozitës, përkatësisht me udhëheqjet e Partisë Socialiste dhe të Lëvizjes Socialiste për Integritim.

Delegacioni i Kuvendit të Republikës së Kosovës, mori pjesë edhe në konferencën “ Kosova dhe sfi-dat e saj pas pavarësisë”, e cila u mbajt në Tiranë, nën patronatin e presidentit Topi.

GRATË DEPUTETE DHE PËRFAQËSUESET E OJQ-VE DISKUTOJNË PËR PËRFAQËSIMIN GJINOR NË PROJEKTKUSHTETUTËN E KOSOVËS

Të garantohet me Kushtetutë minimumi i përfaqësimit të grave në institucionet e Kosovës

Organizuar nga Instituti Nacional Demokratik (NDI) dhe Rrjeti i Grave të Kosovës, sot në Kuvendin e Kosovës është mbajtur një takim debati për përfaqësimin gjinor në Projektkushtetutën e Kosovës, në të cilin merrnin pjesë gratë deputete dhe përfaqësueset e OJQ-ve që kanë për interes të tyre mbrojtjen e të drejtave të grave. Megjithëse kanë vlerësuar përparimet në Kosovës, për sa i përket përfaqësimit gjinor në

Kuvendin e Kosovës, pjesëmarrëset në këtë takim kanë shprehur keqardhjen e tyre pse në Projektkushtetutën e Kosovës nuk është paraparë kuota prej 30 për qind e përfaqësimit të grave në institucionet e Kosovës. Gati të gjitha gratë deputete, pjesëmarrëse në takim, dhe përfaqësueset e OJQ-ve që merren me mbrojtjen e të drejtave të grave, janë pajtuar se kuota duhet të përfshihet në Kushtetutë, por janë dalluar në

vleratën e saj: 30 për qind, siç parashihnin rregullat e zgjedhjeve parlamentare dhe vendore, ose 40 për qind siç parash Ligji për barazimin gjinor.

Anëtarja e Komisionit Kushtetues, Xhuljeta Mushkolaj, e cila merrte pjesë në këtë takim, ka mbrojtur qëndrimin se në Kushtetutë nuk do të duhej të përmendeshin kuota të tilla, sepse barazimin gjinor e garanton ligji dhe për faktin se Kushtetuta do të ketë jetë të gjatë, ndërkohë që emancipimi i popullatës së Kosovës edhe në planin e barazisë gjinore do të ecën shumë shpejt.

Gratë deputete dhe sidomos përfaqësueset e OJQ-ve, kanë mbajtur qëndrim të prerë se barazia gjinore duhet të garantohet me Kushtetutë, në të cilën duhet të figurojë edhe kuota për përfaqësimin e grave në institucionet e Kosovës, përfshirë legjislativin, ekzekutivin dhe gjyqësorin.



PYETJE TË DEPUTETËVE QË NUK MORËN PËRGJIGJE

Mosha e pensionimit të profesorëve universitarë dhe mospërfillja e kriterit të numrit të studentëve të rinj

Deputeti Riza Smaka iu ka drejtuar me dy pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Enver Hoxhaj. Në pyetjen e parë ai kërkon nga ministri që të shqyrtohet çështja e pensionimit të profesorëve universitarë, në mënyrë që në kushte të caktuara të mos zbatohet neni i ligjit sipas të cilit profesorët në të gjitha rastet të pensionohen në moshën 65 vjeçare, sikurse veprohet edhe me

punëtorët tjerë. Deputeti Riza Smaka kërkon që pensionimi i profesorëve të bëhet nga mosha 70 vjeçare, duke u mbështetur në disa praktika më të mira të BE-së dhe të SHBA-së për këto raste.

Ndërkaq, në pyetjen e dytë ai shtron çështjen e mospërfilljes së kriterëve të konkursit me rastin e pranimit të studentëve të rinj. Ai thekson se disa fakultete, madje në mënyrë drastike

kanë tejkaluar numrin e paraparë me konkurs të studentëve të vitit të parë. Ai kërkon që pasi të shikohen të dhënat zyrtare të jepet përgjigje në Kuvendin e Kosovës se pse lejohet një veprim i këtillë, përkatësisht të kërkohej përfillja konsekuente e konkursit publik nga ana e fakulteteve.

Në këto pyetje deputeti nuk mori përgjigje në dy seanca plenare.



Studentët e Venedikut gjatë vizitës në Kuvend